



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



Nr. 307/16

Data. 20.07.2016

Prishtinë, 23 qershor 2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_833\_2016

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 4.2 dhe 22.2 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
- Dispozitat e Nenit 7.4 të Licencës së Operatorit të Tregut,
- Kërkesën e KOSTT për derogimin e dispozitave nga Kodi i Rrjetit, Rregullat e Tregut dhe Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit,

në seancën e mbajtur me datë 23.06.2016, nxori këtë:

**V E N D I M**

- I **I lejohet** KOSTT-it derogimi në zbatimin e dispozitave nga Kodi i Rrjetit, Rregullat e Tregut dhe Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit, si në shtojcë të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 13.06.2016 ka pranuar kërkesën e KOSTT për derogim në zbatimin e disa dispozitave nga Kodi i Rrjetit, Rregullat e Tregut dhe Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit. Pas vlerësimit të kërkesës dhe duke pasur parasysh gjendjen aktuale në Sistemin e Transmisionit, Bordi i ZRRE ka parë të arsyeshme që të lejojë shtyrje të afatit në zbatimin e dispozitave nga Kodi i Rrjetit, Rregullat e Tregut dhe Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit në afatet e vendosura si në Shtojcë.

Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit do të mbesin në fuqi.

- II Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.



III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE - së.


**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Shtojcë: Raporti i derrogimeve.


Vendimi i dërgohet:


- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

**Bordi i ZRRE-së**

  
Enver Halimi, kryesues

  
Krenar Bujupi, anëtar

  
Arsim Janova, anëtar

  
Qemajl Mustafa, anëtar

  
Besim Sejfi, anëtar



**RAPORTI I DERROGIMEVE**

*ver. 1.0*

**FO-ÇLRR-014**

*faqe 1 nga 8*

**Raporti i Derrogimeve\_Kodi i Rrjetit, Kodi i Matjes, Rregullat e Tregut dhe Licenca Operatorit  
të Sistemit të Transmisionit**

**Qershor 2016**

